



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 29 Dhjetor 2020

Nr: 42

VENDIM

PËR DEKLARIMIN TË PËRFUNDUAR DHE PA VENDIM PËRFUNDIMTAR TË PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË SHQYRTIMIT TË REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR ISH-FUNKSIONARIN PUBLIK Z. ARMAND HAMIT RAMA, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “n” dhe paragrafi 2 i Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 10 paragrafi 1, shkronja “d”, i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe kreut III paragrafi 3, shkronja “ç”, të Vendimit të Kuvendit Nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Prokurori i Përgjithshëm me shkresën nr. 2114/15 ex 19’ prot., datë 07.12.2020, me lëndë “Dërgohet Vendimi për miratimin e rezultateve të verifikimit” për subjektin vetëdeklarues z. Armand Hamit Rama, këshilltar në Këshillin Bashkiak Tiranë

VËREN

I.

1. Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për subjekte si më poshtë:

- Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë;
- Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave që nuk është deputet;
- Kryetarit të bashkisë apo këshilltarit në këshillin bashkiak;
- Kandidatët për deputet dhe në organet e qeverisjes vendore.



2. Z. Armand Hamit Rama, si kandidat i listës shumëmerore për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Formularin e Vetëdeklarimit më datë 13.05.2019, referuar ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 3871 prot., datë 17.05.2019 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe me shkresën nr. 3872 prot., datë 17.05.2019, ka kërkuar informacion zyra e gjendjes civile.
4. Me shkresën nr. V-1625/1 prot., datë 20.05.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka paraqitur vërtetimin se subjekti deklarues z. Armand Hamit Rama figuron me statusin "I Padënuar", brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
5. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka paraqitur të dhënat personale për subjektin deklarues z. Armand Hamit Rama.
6. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vërejtë se nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, përgjigjes së ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, kandidati nuk ishte në kushtet e moszgjedhshmërisë dhe vendosi me Vendimin Nr. 623 datë 22.05.2019 "Miratimin e listave shumëmerore të kandidatëve për anëtar në këshillin e bashkisë të paraqitura nga Partia Socialpuntore Shqiptare për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019".

II.

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të detyrave të përcaktuara në shkronjën "ç", paragrafi 3 e Kreu V të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, për shkak të deklarimit të të dhënave për dëbim nga territori i një shteti anëtar i BE-së, me shkresën nr. 14094 prot., datë 31.07.2019 ka përcjellë të dhënat e administruara nga KQZ për kontroll të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, për subjektin deklarues z. Armand Hamit Rama, kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë.

2. Me shkresën nr. 2114/15 ex19' prot., datë 07.12.2020, Prokurori i Përgjithshëm, Sektori i Verifikimit të Integritetit pranë Drejtorisë së Mardhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimin e rezultatit të Verifikimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen apo ushtrojnë funksione publike", për subjektin z. Armand Hamit Rama, me funksion Këshilltar në Këshillin e Bashkisë Tiranë.

Sipas vendimit të Prokurorisë së Përgjithshme "Për miratimin e rezultatit të Verifikimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 për subjektin z. Armand Hamit Rama me funksion Këshilltar në Këshillin e Bashkisë Tiranë", rezulton se Prokuroria e Përgjithshme i është drejtuar institucioneve të ndryshme për verifikim të mëtejshëm:

- i. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën nr. V-2575/1 prot., datë 07.08.2019 ka vënë në dispozicion të Prokurorisë së Përgjithshme dokumentin "Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore nr. 11 prot., datë 06.08.2019, sipas të cilës rezulton se z. Armand Hamit Rama, figuron "I Padënuar" brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
- ii. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 6518/1 prot., datë 14.08.2019, ka paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme të dhënat personale të subjektit z. Armand Hamit Rama, sipas Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile. Referuar këtyre të dhënave rezulton se Këshilltari i Këshillit të Bashkisë Tiranë, z. Armand Hamit Rama, nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.



- iii. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti i Policisë Kriminale me shkresën nr.12491/1 prot, datë 08.08.2019, deklaroi se z. Armand Hamit Rama, lindur në datë 10.09.1989, nuk ka qënë i ndaluar apo arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit.
- iv. Zyra e Interpolit, me shkresat nr.10012K1/6 prot, datë 16.08.2019; nr.10012K1/17 prot, datë 12.11.2019; nr.1400/1 prot, datë 29.01.2020 ka përcjellë në Prokurorinë e Përgjithshme se në arkivën e ZQK Interpol Tirana nuk figurojnë të rregjistruara praktika me zyrat homologe për përfshirje në veprimtari kriminale. Shtetasi Armand Rama, nuk figuron person i shpallur në kërkim ndërkombëtar. Nga Zyra Interpol Norvegji, rezultoi se shtetasi Armand Hamit Rama, i datëlindjes 10.09.1989, është dënues me 45 ditë burgim nga Gjykata e Distriktit Romerike, për veprën penale të “Falsifikimit të dokumentave”. Vuajtja e dënimit ka zgjatur nga data 23.03.2012 deri në datë 02.05.2012, datë në të cilën është liruar.
- v. Nga verifikimet e kryera nga Prokuroria e Përgjithshme në sistemin TIMS, rezultoi se z. Armand Hamit Rama, ka të njëjtat gjenealitete të cilat i ka deklaruar në Formularin e Vetëdeklarimit. Në sistem rezultoi se ky shtetas është deportuar me datë rregjistrimi 03.05.2012.
- vi. Ministria e Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë, me shkresën nr. 2107/2 prot., datë 02.11.2020, ka përcjellë përgjigjen zyrtare të autoriteteve norvegjeze të drejtësisë. Referuar “Dëshmisë së penaltetit” dhe dispozitivit të vendimit penal, përcjellë nga autoritetet norvegjeze, shtetasi Armand Hamit Rama, i datëlindjes 10.09.1989, është dënues nga Gjykata e Rrethit Nedre Romerike, në datë 22.03.2012 me 45 ditë burgim, për veprën penale “Falsifikimi i dokumentave”. I dënuesi deklaroi se e pranoi dënimin. Qëndrimin në burgim i zbriten 5 ditë burg, për shkak se ka qëndruar në paraburgim.

III.

1.Referuar nenit 33, 42, 47 dhe 87 të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve thirri ditën e enjte, datë 17.12.2020, ora 12:00 si palë në këtë shqyrtim administrativ, z. Armand Hamit Rama, për të dhënë mendime dhe shpjegime për faktet dhe rrethanat e çështjes. Njoftimi ju bë i njohur me mjetet e komunikimit telefonik. Njoftimi u afishua edhe në ambientet publike të KQZ-së si dhe në faqen e internetit.

- i. Subjekti z. Armand Hamit Rama kërkoi shtyrje të seancës dëgjimore me qëllim njohjen me dokumentacionin e dosjes dhe rezultatet e verifikimit të përcjella nga Prokuroria e Përgjithshme.
- ii. Seanca e dëgjimore e radhës u caktua të zhvillohej me datë 22.12.2020 ora 12:00.
- iii. Seanca e datës 22.12.2020 u shty me kërkesë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në datë 29.12.2020 ora 13:00
- iv. Seanca e datës 29.12.2020, ora 13:00 u zhvillua në mungesë të palës z. Armand Hamit Rama, pasi ai nuk u paraqiti.
- v. Në seancë u administrua dorëheqja e z. Armand Hamit Rama nga funksioni i anëtarit të këshillit bashkiak nr. 2655 prot. datë 29.12.2020.

Referuar paragrafit 2 dhe 3 të nenit 90 dhe nenit 95 të Ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është në diskrecionin e organit publik të deklarojë të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “n” dhe paragrafi 2 i Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; paragrafi 2 dhe 3 i nenit 90 dhe neni 95 i ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”,

VENDOSA:

1. Të deklaroj të përfunduar procedurën administrative pa vendim përfundimtar, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura është bërë i pamundur, për shkak të dorëheqjes të z. Armand Hamit Rama nga funksioni i anëtarit të këshillit bashkiak Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

